

ÇFARË DUHET PËR TË APLIKUAR



NIPT/NUIS ME STATUS AKTIV

I domosdoshëm për të gjithë aplikantët (fermerë, grup fermerësh, persona fizikë/juridikë, SHBB).

TË DHËNA TË PËRDITËSURA NË REGJISTRIN RUDA

Gjedhët, delet, dhitë, zgjojet duhet të jenë të regjistruara dhe të matrikulluara.

NAFTA PËR PUNIMET E MEKANIZUARA NË BUJQËSI

- Faturë blerje për një nga inputet si material mbjellës (farëra ose fidanë)/ plehra kimike/pesticide;
- Faturë për shitjen e prodhimit.

SIGURIME SHOQËRORE

Sigurime shoqërore të paguara për të përfituar në masat respektive (me përjashtim të masës për mbështetje me naftë).

LLOGARI BANKARE AKTIVE

APLIKANTI NUK DUHET TË JETË DEBITOR NDAJ AZHBR/MBZHR

 Procedura e aplikimit nga portali e - Albania, përfundon me dërgimin me sukses të formatit elektronik të formularit të aplikimit.



SKEMA KOMBËTARE 2025

MBËSHTETJE NË BUJQËSI

14 Prill - 30 Maj



Telefona falas AZHBR

 0800 83 83

www.azhbr.gov.al

MASAT MBËSHTETËSE



MASA 1

Pagesa për gjedhë të matrikulluar, në vlerën deri në **10 000 (dhjetë mijë)** lekë/krerë lopë/mëshqerrë dhe deri në **5 000 (pesë mijë)** lekë/krerë viça për fermer/aplikant, me jo më pak se **10 (dhjetë)** krerë gjedhë. Për pjesën **mbi 50 (pesëdhjetë)** krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me **50%**, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”.

MASA 2

Pagesa në vlerën deri në **1 200 (një mijë e dyqind)** lekë/krerë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese) për fermer/aplikant, me jo më pak se **100 (njëqind)** krerë dele dhe/ose dhi. Për pjesën **mbi 300 (treqind)** krerë, masa e përfitimit zvogëlohet me **50%**, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”.

MASA 3

Mbarështimi i bletarisë, në vlerën deri në **1 000 (një mijë)** lekë për zgjua për fermer/aplikant, me jo më pak se **50 (pesëdhjetë)** zgjoje. Për pjesën **mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë)** zgjoje, masa e përfitimit zvogëlohet me **50%**, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”.

MASA 4

Pagesa, në vlerën deri në **200 000 (dyqind mijë)** lekë për ha për kultivimin e perimeve, rrushit për tavolinë në serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike për fermer/aplikant, me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se **1 (një)** ha. Për sipërfaqen **mbi 5 (pesë)** ha, masa e përfitimit zvogëlohet me **50%**, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”. Përfitojnë pagesë shtesë fermerët që përdorin kontrollin biologjik të dëmtuesve të perimeve (domate, specat, tranguj, luleshtrydhe).

MASAT MBËSHTETËSE



MASA 5

Pagesa për kultivimin e bimëve mjekësore e aromatike, në vlerën deri në **30 000 (tridhjetë mijë)** lekë/ha për fermer/aplikant, me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se **1 (një)** ha. Për sipërfaqen **mbi 10 (dhjetë)** ha, masa e përfitimit zvogëlohet me **50%**, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”.

MASA 6

Fermat organike për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën **100 000 (njëqind mijë)** lekë, në vitin e dytë **150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë)** lekë, në vitin e tretë **150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë)** lekë dhe **200 000 (dyqind mijë)** lekë për fermë të certifikuar.

MASA 7

Implementimi dhe certifikimi global GAP, përfshirë mbulimin e kostove të analizave të produkteve, në perime, fruta, rrush, ullinj, agrume dhe kultura të tjera bujqësore të certifikueshme, në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore:

- Jo më shumë se **175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë)** lekë për sipërfaqe jo më pak se **1 (një)** ha për certifikim individual;
- Jo më shumë se **500 000 (pesëqind mijë)** lekë për sipërfaqe jo më pak se **3 (tre)** ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se **10 (dhjetë)** ha në fushë të hapur për certifikim në grup, me minimum **10 (dhjetë)** fermerë të përfshirë;
- Jo më shumë se **700 000 (shtatëqind mijë)** lekë për sipërfaqe jo më pak se **15 (pesëmbëdhjetë)** ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se **30 (tridhjetë)** ha në fushë të hapur për certifikim në grup, me minimum **20 (njëzetë)** fermerë të përfshirë.

MASA 8

Mbështetje me naftë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi, me vlerë në varësi të kulturave bujqësore të mbjella.